



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:045571
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05519763

C.nr.84/21

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.H. nga fshati C./Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson Avdullah Hoti avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Malishevës/Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti “kompensimi i pagës së jubilarit të tretë”, vlera e kontestit 421.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 29.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadija e paditësit I.H. nga fshati C./ Malishevë dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit I. H. në emër kompensimit të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës, në vlerë të një page bazë (vlera e pagës bazë 421.00 euro), t’ia kompensoj shumën prej **421.00 € (katërqind e njëzetë e një euro)**, me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë me datë 08.03.2021 dhe në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.
- II. OBLIGOHET** e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 98.00 euro (nëntëdhjetë e tetë euro) dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 78.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 euro në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve:

Paditësi I.H. nga fshati C./Malishevë, përmes të autorizuarit të tij Avdullah Hoti avokat nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datën 08.03.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e një page jubilar-pagës së jubilarit të tretë.

Në padi, i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësi prej datës 01.09.1989 është duke punuar me kontratë pune si arsimtar në SH.F.M.U. “I. K.” në C., gjithsej i ka 30 vite përvojë pune dhe lidhur me këtë, pranë të paditurës me datë 01.02.2021 ka paraqitur kërkesë për kompensimin e pagës për jubilarin e tretë, por e njëjta kërkesë është refuzuar nga e paditura, me

arsyetimin se ka mungesë të mjeteve financiare dhe nuk kanë planifikime buxhetore për vitin 2021.

Meqenëse e paditura nuk i ka përfillur dispozitat nga Kontrata Kolektive për rastet e pagave jubilarë të punëtorëve të arsimit, paditësi ka kërkuar nga gjykata që pas administrimit të provave të nxjerrë aktgjykim me të cilin do të aprovohet kërkesëpadia e paditësit I. H. dhe të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj një pagë jubilarë në emër të jubilarit të tretë, duke e llogaritur kamatën ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore sipas tarifës së avokatëve.

E paditura Komuna e Malishevës, përmes të autorizuarit së saj Mujë Sahitaj-avokat publik i komunës, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 12.12.2022, ku ka theksuar se sipas Kontratës Kolektive lidhur me pagesën e jubilarit të tretë, komuna e ka përmbushur detyrimin, por paditësi nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me përvojën e punës.

Ka shtuar se e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur mes SBASHK-ut dhe MASHT-it është shkëputur dhe tani nuk është në fuqi dhe se palët që e kanë nënshkruar nuk kanë pasur legjitimitet. Meqenëse kjo kontratë nuk është më në fuqi pasi është shkëputur nga MASHT, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj padinë e paditësit pasi që ata nuk kanë legjitimitet të palës aktive, por këtë legjitimitet e ka MASH, dhe po ashtu i kontestojnë edhe shpenzimet e procedurës.

Vlerësimi i gjykatës:

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto prova dhe atë: Kërkesën e paditësit drejtuar Komunës së Malishevës-Drejtorisë së Arsimit të datës 01.02.2021 dhe përgjigjen nga e paditura nr. 11/255 të datës 26.02.2021, Vërtetimin mbi përvojën e punës të lëshuar nga drejtoresha e SHFMU "I.K." në C. me nr. të protokollit 725/2 të datës 04.02.2021, Kontratën e punës nr.11/342 të datës 06.10.2015, listat e pagave nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe letërnjoftimi e paditësit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga kontrata e punës nr.11/342 për paditësin e lëshuar nga Komuna e Malishevës-Drejtoria për Arsim (këtu e paditura), paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën SHFMU "I. K." në C./Malishevë, si arsimtar i teknologjisë-informacionit.

Nga vërtetimi mbi përvojën e punës me nr. prot.725/2 i lëshuar nga drejtoresha e SHFMU "I.K.", vërtetohet fakti se paditësi është punësuar si mësimdhënës i TIK-ut në SHFMU "I. K." nga data 01.09.1989 ku të njëjtën punë e kryen edhe tani, dhe sipas kësaj del se paditësi i ka mbi 30 vite përvojë pune.

Nga kërkesa e paditësit e datës 01.02.2021 drejtuar Komunës së Malishevës, vërtetohet se paditësi ka bërë kërkesë për kompensimin e pagës së jubilarit të tretë, por në përgjigjen me nr. 11/255 të datës 26.02.2021, e paditura ka theksuar se kërkesa është e porealizueshme, për shkak të mos planifikimit buxhetor dhe kufizimeve buxhetore.

Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet fakti se paditësi pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro, kjo listë e pagave vërtetohet edhe me numrin personal nga letërnjoftimi i paditësit.

Baza ligjore:

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së ku thuhet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Vërtetimin, kontratën e punës dhe listat e pagave, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1 të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”* Andaj, meqë disa nga këto dokumente janë të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, dhe janë prova me të cilat vërtetohen faktet lidhur me marrëdhënien dhe përvojën e punës, kështu që gjykata ua fali besimin e plotë.

Kontestuese mes palëve nuk ishte fakti nëse paditësi ishte i punësuar tek e paditura, por kontestues ishte fakti nëse paditësit i takonte shpërblimi jubilar për 30 vite përvojë pune dhe nëse pala e paditur ka legjitimitet në këtë çështje kontestimore Pra në këtë procedurë për gjykatën ishte e rëndësishme që ta vërtetoj bazën ligjore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe besueshmërinë e saj me prova e po ashtu edhe pretendimet e palës së paditur se ajo nuk ka legjitimitet për të qenë palë në këtë procedurë.

Bazuar në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90/01 Dhjetor 2010, në dispozitat e nenit 90 par. 5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, ku me nenin 3 paragrafin 2 përcaktohet se: *“I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në*

pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shpërblimit jubilar, u vendos që të njëjtën ta aprovoj tërësisht dhe atë në lartësi të një pagës bazë (421.00 euro) për 30 vite përvojë pune.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe 22.01.2021.

Me nenin 35 par. 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 është paraparë se: *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: nën par.8.3: **“Për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë”**, pra në rastin konkret paga bazë e paditësit është 421.00 euro, atëherë edhe shuma e shpërblimit jubilar është 421.00 euro.*

Lidhur me përgjigjen e dhënë nga e paditura ku ka theksuar se e kanë përmbushur detyrimin dhe se paditësi nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me përvojën e punës, gjykata nuk ia fali besimin për arsye se e paditura me asnjë provë nuk e ka dëshmuar këtë, kurse sa i përket përvojës së punës, paditësi këtë e ka argumentuar me vërtetimin nr. prot. 725/2 të datës 04.02.2021 ku ceket se paditësi është i punësuar nga data 01.09.1989, pra realisht i ka mbi 30 vite përvojë pune.

Sa i përket pretendimeve se e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur mes SBASHK-ut dhe MASHT-it është shkëputur dhe tani nuk është më në fuqi dhe se palët që e kanë nënshkruar nuk kanë pasur legjitimitet, ky pretendim është i pabazuar sepse siç u cek edhe më lart, padia është dorëzuar në gjykatë me datë 08.03.2021 pra në kohën kur Kontrata Kolektive e Arsimit ka qenë në fuqi e siç dihet Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 ka qenë në fuqi deri me datën 21.01.2021, kurse Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 ka qenë në fuqi deri me datën 21.11.2022 kur edhe është anuluar nga MASHT, kjo bazuar edhe në Mendimin Juridik për Shpërblimin Jubilar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr.40/2023 të datës 27.02.2023.

Në anën tjetër për gjykatën nuk mund të qëndroj pretendimi i të paditurës se pasi që ajo nuk ka qenë nënshkruese e Kontratës Kolektive, asaj i mungon legjitimiteti në këtë çështje. Kjo për arsye se e paditura është punëdhënësi i paditësit dhe të njëjtit janë në një raport kontraktual të marrëdhënies së punës, e po ashtu edhe fakti se KKA-ja është e lidhur në nivel vendi, me efekt të zbatueshëm në të gjithë Republikën e Kosovës. Lidhur me këtë, me nenin 90, par 2.1 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, është paraparë që: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në nivel të vendit”* dhe mbi këtë bazë kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në Kontratën Kolektive me numër 2056 të datës 18.04.2017 dhe numër 105 të datës 22.01.2021, të lidhura në mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në njërën anë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) në anën tjetër

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 453 par. 1 dhe 2 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se (Neni 453.1): *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”*, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, e cila rregullore përcakton se përpilimi i padisë në kontestet e vlerës së vogël (nën 500.00 euro, siç është në rastin konkret) është në shumën prej 78.00 euro, ashtu që vendosi që paditësit t’ia njoh shpenzimet e procedurës duke e detyruar të paditurën që t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 98.00 euro dhe atë në emër të parashtrimit të padisë shumën 78.00 dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe 398 të LPK-së.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.84/21, datë 28.03.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.